

Në bazë të përbërjes së kabinetit qeveritar i votuar në Kuvend në fillim të shkurtit 2020, kemi të bëjmë me bashkim të ministrive apo pjesëve të tyre në ministri tjera por jo shuarje (suprimim) të ministrive. Kjo sepse dikasteret ministrore (apo pjesë të tyre) vetëm janë bartur në ministri që janë vlerësuar se kanë kuptim më shumë të jenë kështu se sa si kanë ekzistuar në të kaluarën;

- Ligji që mbulon fushën e shërbimit civil (qoftë Ligji për shërbimin civil qoftë Ligji për zyrtarët publik) e rregullon risistemimin e nëpunësve civil që klasifikohen tepriçë si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së një institucioni;

- Sipas Ligjit për shërbimin civil, risistemimi ka dy afate: një muaj për risistemim në një pozitë ekuivalente (nëse ka të tillë) dhe deri në një vit për një ricaktim në një pozitë tjetër në kuadër të shërbimit civil;

- Sipas Ligjit për zyrtarët publik, risistemimi nuk ka afate dhe duhet të ndodhë brenda të njëjtës kategori (jo domosdo në pozitën e njejtë). Për këtë, krijohet një komision ristrukturimi i cili drejtohet nga njësia e pranimit (njësia e personelit) të institucionit përkatës dhe përbëhet nga përfaqësues të ministrive ose organeve që shërbejnë si alternativa për risistemim;

- Mënyra dhe procedura e risistemimit të nëpunësve civil të klasifikuar tepriçë është e varur se cili ligj do të mbulojë shërbimin civil, Ligji për shërbimin civil apo Ligji për zyrtarët publik i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese deri më 28 shkurt 2020;

- Katër nga gjashtë ministrinë që bashkohen me ministri tjera, bashkohen si tërësi në ministrinë amë kurse dy tjera ndahen në dysh: Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në total, minimumi janë rreth 100 pozita në gjashtë ministri të cilat krijojnë dyfishime me pozita të njëjta në ministrinë amë dhe kryesisht janë të nivelit drejtues;

- Ministrinë që bashkohen si tërësi (pra nuk ndahen në mes dy ministrive) kanë mundësinë e risistemimit më të lehtë dhe uniform dhe sistemimi bëhet rast pas rasti i cili më së shumti mund të jetë ulje në pozitë të nëpunësit me pozitën e njejtë në ministrinë amë. Në anën tjetër, ministrinë që

ndahen në dysh sidomos nëse ministrinë amë integrojnë vetëm departamentet funksionale, sistemimi i nëpunësve civil mund të jetë i ndarë në më shumë se një ministri;

- Numrin më të vogël të nëpunësve civil tepicë që krijohen nga riorganizimi e kanë ministrinë me portfolio të gjerë sepse sidomos pjesa e zyrtarëve të kategorisë profesionale sistemohen lehtë për shkak të vëllimit të punëve që kanë ministrinë që bashkohen.